

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Leonita Lajçi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.SH., nga Gjilani, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.555/2017, të dt.15.08.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 29.11.2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet**- si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit A.SH., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.555/2017, i dt.15.08.2018, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.555/2017, të dt.15.08.2018, është shpallur fajtor i akuzuari A.SH., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par 1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është obliguar që ta paguajë në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë në pajtim me të akuzuarin do të zëvendësohet në urdhër për punë në dobi të përgjithshme, duke llogaritur për çdo 8 (tetë) orë të punës, nga 20 (njëzetë) €. Nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënitimit me gjobë në urdhër për punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzetë) €.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë i akuzuari A.SH., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të priset, dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.1150/2018, të datës 07.11.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e të akuzuarit A.SH., ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, të hudhet si e palejuar.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

### **Ankesa e të akuzuarit A.SH., nga Gjilani, nuk është e bazuar.**

Sipas ankesës së të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke mos cekur ndonjë arsye për këtë bazë ankimore, mirëpo kolegji i kësaj gjykate të njëjtin e ka shikuar sipas detyrës zyrtare sa i përket kësaj baze ankimore në kuptim të nenit 394 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, dhe me dispozitivin e të njëjtit, sepse përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare, të cilat karakterizojnë veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par 1 të KPK. Gjithashtu kolegji i kësaj gjykate, ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar është punuar në kuptim të nenit 370 par 6 lidhur me par 7 të KPPK, duke e përmbajtur formën e kërkuar me shkrim, respektuar formën e aktgjykimit, si dhe karakteristikat të cilat duhet ti ketë një aktgjykim, ndërsa gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë ka dhënë arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, duke paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye konsiderohen të vërtetuara apo të pa vërtetuara, si dhe në mënyrë të qartë ka paraqitur edhe saktësinë e secilës provë e cila e karakterizon çështjen penale, për zgjidhjen e së njëjtës, andaj, aktgjykimi gjykatës së shkallës së parë si i tillë është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate.

Sipas ankesës së të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të shkeljes së ligjit penal, duke mos cekur ndonjë arsye për këtë bazë ankimore mirëpo kolegji i kësaj gjykate në kuptim të neni 385 të KPPK, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal, se vepra penale për të cilën është akuzuar i akuzuari parashihet me ligjin e aplikueshëm, se nuk ekzistojnë rrethana që përjashtojnë të akuzuarin nga përgjegjësia penale dhe ndjekja penale, se gjykata në mënyrë të drejtë ka zbatuar ligjin i cili ka qenë aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, se gjykata ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, andaj, aktgjykimi i ankimuar është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate.

Ankesa e të akuzuarit A.SH., sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, nuk është e lejuar, ngase në kuptim të nenit 383 par 2 të KPPK, përcaktohet se *“Ndaj aktgjykimit nuk mund të ushtrohet ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike kur ka marrëveshje mbi pranimin e fajësisë apo kur i akuzuari ka pranuar fajësinë për të gjitha ika e aktakuzës dhe trupi gjykues është*

*pajtuar me pranimin e tillë”, ndërsa i akuzuari në rastin konkret, në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, dhe se pranimi i tillë është bërë konform dispozitës ligjore nga neni 248 par 1 të KPK, andaj, kolegji i kësaj gjykate në kuptim të nenit 400 të KPPK, ankesën e ka hedhur poshtë si të pa lejueshme.*

Për kundër asaj që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, kolegji i kësaj gjykate të njëjtin e ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare, dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, andaj, duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, kolegji vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se është penduar për veprën penale të kryer, se është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me ligjin, se ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tilla apo të ngjashme penale, ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësuar shkallën e dëmit të shkaktuar dhe lëndimin trupor të shkaktuar të dëmtuarit, andaj, në prani të këtyre rrethanave, e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se në mënyrë të drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore neni 74, 75 dhe 76 të KPK, përkitazi me rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimeve, zbutjen e dënimeve, si dhe kufijtë e zbutjes së dënimeve, dhe se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1. nr.1146/2018 të datës 29.11.2018**

**B.profesionale**  
**Leonita Lajçi**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Biljana Rexhiq**